

**AKT- THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“ELITE PRO” shpk**

Ne Durres, sot me date 05/12/2023, ortakia themeluese e shoqerise

**“ELITE PRO” shpk**

**Znj. Iva Myzyri**, e bija e Kastriotit, i datelindjes 12.04.1992, lindur ne Durres e banues ne Durres, shtetase Shqiptare, madhore, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer J25412068P.E cila me cilesine e “Ortakes themeluese” kerkoj redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, **“ELITE PRO” shpk.**

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

**Shoqeria “ELITE PRO” shpk**

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria **“ELITE PRO” shpk**, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetesia shqiptare:


**Znj.Iva Myzyri**, e cila pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqeria e ka seline ne: Lagjja 1, Brenda Autoritetit Portual Durres, Sheshi i Trageteve, Durres. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve themelues.

**Neni 4**



## Objekti i veprimtarise

Veprimtari ne fushen e sherbimeve si agjensi doganore, spedicionere dhe sherbimeve portuale ne pergjithesi per vete dhe te trete. Agjensi detare. Sherbim transporti brenda dhe jashte vendit si me mjetet e veta ashtu dhe me mjetet e te treteve. Konsulence per legjislacionin fiskal, ekonomik si dhe konsulence per investime brenda dhe jashte vendit. Shoqeria mund te kryeje te gjitha operaconet mbi pasurite e paluajtshme dhe te luajtshme financiare dhe tregtare. Agjensi imobiliare, import eksport dhe tregtimi me shumice dhe pakice te artikujve ushqimore, industriale dhe automjeteve. Projektim dhe ndertim te objekteve civile, industriale. Veprimtari komisionere, ndermjetesimi. Ndermjetes ne sigurime dhe agjent sigurimesh, etj.

### Neni 5 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

### KREU II Kapitali Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqindë mijë lekë), i cili ndahet ne 1 kuota, ne raport me kontributin e dhene nga ortakët ne shoqeri ku ortakët zoterojne kuota te ndare si me poshte :


Ortaku Znj. Iva Myzyri,: zoteruese e nje kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

#### Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.



Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

Ortaket e shoqerise jane organi vendimmarres i shoqerise. Ortaket e shoqerise jane organi vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaket vendosin per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.



Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

#### Neni 9

##### Administrimi

Administrator i shoqerise "ELITE PRO" sh.p.k caktohet brenda ortakerise. Ortaku Z. Bruno Senko emerohet Administartor i shoqerise per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertesitje. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblea e ortakeve te shoqerise.

#### Neni 10

##### Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqrise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqrise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare.



Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e asamblese në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Administratori, si së bashku edhe vecas njeri tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori e përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në mardhëniet me të tretet nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merret përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretet e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretet nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë mjaftueshme.

#### **Neni 11**

#### **Viti Financiar**

Viti Financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë Financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet në 31 dhjetor.

#### **Neni 12**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohezhgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të ortakëve themelues
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar përzullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"
- e) me vendim të gjykatës

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë "shoqëri në likuidim e sipër"



**Neni 13**

**Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit “Per tregtaret dhe shoqerit tregtare”, Kodit Civil dhe cfar do ligji tjeter specific ne Republikën e Shqiperis.

**Neni 14**

**Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare “**ELITE PRO**” sh.p.k, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

Znj.IVA MYZYRI

